



Ngjeshja e origjinalit	5	Nr. Protokoll	2225
Organi i autorizuar		Organi i autorizuar	
Nr. i fletës	2	Data	28.08.2022
Nr. i fletës			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

DARDANIA
2022

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 28.08.2022
Nr. 5. 2225

Komisioni për licencimin e BPrAL / Kolegjeve Private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 2225 të datës 22.08.2022 të parashtruar nga BPrAL-Kolegji "DARDANIA" dhe mori këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për Licencim e Kolegjit "DARDANIA".
2. I ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për vitin akademik 2022/23.
3. I lejohej vazhdimi i studimeve me studentët aktual aktiv.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Bazuar në dispozitat ligjore të lartëcekura, Komisioni për Licencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 2225 të datës 22.08.2022 të parashtruar nga Kolegji "DARDANIA", vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim sipas Ligjit të Arsimit të Lartë neni 14 si dhe UA nr. 25/2012, neni 14 paragrafi 1.1, prandaj komisioni i MASHTI-t, refuzon kërkesën për licencim.

Duke u bazuar në përgjigjen (komunikimet elektronike – 9 shtator 2022) që i ka dhënë personi zyrtar i Agjencionit të Kosovës për Akreditim rektorës së Kolegjit "Dardania" jep sqarimet lidhur me qështje ligjore se si dhe kur mund të vendos apo jo Agjencioni për Akreditimin të këtij institucioni. Po ashtu në komunikimin me email të datës 7 shtator 2022 zyrtari i Agjencionit sqaron se Kolegjit Dardania i skadon akreditimi institucional me datë 01.10.2022 dhe natyrshëm mungon Akreditimi institucional dhe i programeve për këtë institucion.

Kolegjit "DARDANIA", nuk i lejohet regjistrimi i studentëve të rinj, por i lejohet vazhdimi i punës me studentët aktual aktiv deri në përfundim të studimeve bazuar në ligjin dhe aktet nënligjore që përcaktojnë kohëzgjatjen e studimeve.

Komisioni për licencim i MASHTI-t, duke marrë parasysh mungesën e fakteve të ofruara në dokumentacionin për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Sekretarit të përgjithshëm në MASHTI;
3. Departamentit të arsimit të lartë në MASHTI;
4. Inspektoratit të Arsimit;
5. Arkivit.

